

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Unionit Evropian
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	I, semestri I
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr. Hajredin Kuci
Detajet kontaktuese:	<a href="mailto:hajredin.kuci@uni-pr.edu">hajredin.kuci@uni-pr.edu</a>
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Planprogrami për këtë lëndë është strukturuar në formatin që të japë njohuri më të thelluara për historikun e së Drejtës së UE-së, institucionet e UE-së, funksionimin e UE-së, procesin e zgjerimit të UE-së, Tregun e brendshëm të UE-së, sistemin ekonomik dhe financiar të UE-së, marrëdhëniet ndërkombëtare të UE-së dhe politikat e saj.</p> <p>Njohuritë për fushat në fjalë do t'u jepen studentëve përmes elborimit edhe në aspektin praktik përmes rasteve dhe detyrave që do t'u adresohen atyre gjatë semestrit përkatës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Planprogrami përbëhet nga 6 sesione apo pjesë ku secila nga këto ligjërohet brenda 2-3 javësh.</p> <p><b>Pjesa e parë</b> ligjërohet për dy javë dhe përfshinë historikun e UE-së në kontekstin juridik ku studentëve u ofrohen njohuri më të thelluara lidhur me traktatet themeltare dhe amendamentuese të UE-së gjithnjë duke u bazuar në rrethanat dhe faktorët e karakterit juridik që ndikuan në nxjerrjen dhe amendamentimin e tyre. Përveç kësaj në këtë pjesë ofrohen njohuri të thelluara lidhur me historikun e të Drejtës së UE-së dhe përmbajtjen e saj, për burimet dhe hierarkinë e tyre si dhe për raportin hierarkik në mes të së Drejtës së UE-së me</p>

të Drejtën Ndërkombëtare dhe të Drejtën e vendeve anëtare të saj.

**Pjesa e dytë** do të ligjërohet brenda tre javësh dhe përfshinë institucionet e UE-së dhe u ofron studentëve njohuri më të thelluara lidhur me institucionet me karakter politik dhe ndërqeveritar, me procesin e vendimmarrjes në kuadër të UE-së si dhe me funksionet apo rolin specifik të institucioneve të UE-së në këtë proces.

**Pjesa e tretë** do të ligjërohet brenda tre javësh dhe përfshinë procesin e zgjerimit të UE-së. Në këtë pjesë procesi i zgjerimit trajtohet shkurtimisht në aspektin historik që do të thotë se fokusi i trajtimit do të jetë trajtimi juridik dhe vlerësimi i këtij procesi në faza të ndryshme të zgjerimit, pra, nga zgjerimi i UE-së i mbështetur në kriteret ad hoc deri të zgjerimi i UE-së i mbështetur në kriteret formale për anëtarësim (Kriteret e Kopenhagës). Po ashtu në këtë pjesë, përveç tjerash studentëve do tu ofrohen njohuri të thelluara për Procesin e Stabilizim Asocimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, për rastin e Kosovës drejtë UE-së, pozitën juridike aktuale të Kosovës në procesin e integrimi evropiane si dhe për rolin, rëndësinë, efektin juridik, benefitet dhe sfidat e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (tani më të nënshkruar në mes të Kosovës dhe UE-së).

**Pjesa e katërt** do të ligjërohet brenda dy javësh dhe përfshinë tregun e brendshëm dhe sistemin ekonomik dhe financiar të UE-së më fokus funksionimin e tregut të brendshëm, bazën juridike të tij, harmonizimin e legjislacionit nacional në fushën e tregut të brendshëm të UE-së, Unionin Ekonomik dhe Monetar, Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, rolin e Bankës Qendrore Evropiane, si dhe funksionimin dhe rolin e Eurozonës.

**Pjesa e pestë** do të ligjërohet brenda dy javësh dhe përfshinë Marrëdhëniet e UE-së me jashtë, përkatësisht marrëdhëniet ndërkombëtare të UE-së

ku studentëve u ofrohen njohuri të përgjithshme lidhur me marrëdhëniet e UE-së më vendet e treta, rolin e Përfaqësuesit të Lartë të UE-së për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, për misionet civile, diplomatike dhe ushtarake si dhe rolin e UE-së në ruajtjen e paqes.

**Pjesa e gjashtë** do të ligjërohet brenda dy javësh dhe përfshinë politikat e përbashkëta të UE-së qoftë ato të brendshme qoftë në relacion me vendet e treta. Përveç kësaj, studentëve do tu ofrohen njohuri specifike lidhur me politikën e fqinjësisë e njohur si European Neighborhood Policy (ENP).

<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohuri të thelluar të funksionimit të UE-së e sidomos zbatimit dhe efektit juridik të së Drejtës së UE-së;</li> <li>• Njohuri të thelluara lidhur me procesin legjislativ apo te vendimmarrjes në kuadër të UE-së;</li> <li>• Njohuri të thelluar lidhur me procesin e zgjerimi të UE-së, kriteret e anëtarësimit dhe fazat e anëtarësimit në UE-në mënyrë specifike për rastin e Kosovës;</li> <li>• Njohuri teorike dhe raste praktike lidhur me funksionimin e Tregut të Brendshëm të UE-së;</li> <li>• Njohuri te thelluara lidhur me politikat e UE-së dhe marrëdhëniet e UE-së me jashtë etj.</li> </ul>
---	--

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	2	10	20

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	5	15														
Projektet, prezentimet ,etj	3	5	15														
<b>Totali</b>			<b>186</b>														
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>																	
	<p>Ligjërimi, diskutimi në klasë, pjesëmarrja aktive në debat, konsultat rreth përgatitjes së punimeve-hulumtimeve, prezantimi punimeve dhe eseve dhe çështje të tjera që ndërlidhen më lëndën.</p> <p>Ligjërata, 3 orë në javë (p.sh një ligjëratë në javë apo bllok ligjëratash të specifikuar sipas këtij syllabusi si më poshtë)</p>																
<b>Metodat e vlerësimit:</b>																	
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përgatiten gjashtë (6) ese të shkurtra që ndërlidhen me temat e ligjëratave të cilat parashihen në këtë syllabus, të cilat duhet të jenë të formatit si në vijim: në formë të shkruar dhe të jenë vlerësim kritik origjinal i ndonjë libri apo punimi/artikulli shkencor (paper) të lëmisë <b>(20%=20 pikë)</b>.</li> <li>• Një punim seminarik (hulumtim shkencor) për njërin nga temat përkatëse me forma si në vijim: në formë të shkruar, me 6000-8000 fjalë, i cili duhet të përmbajë pjesë origjinale nga hulumtimi përkatës, duhet të shkruhet në bazë të standardeve dhe do të mbrohet publikisht në klasë <b>(40%=40 pikë)</b>.</li> <li>• Provimi Përfundimtar <b>(40%=40 pikë)</b>.</li> </ul> <p>Në bazë të pikëve si më poshtë përcaktohet edhe nota:</p> <table> <thead> <tr> <th>Vlerësimi në %</th> <th>Nota përfundimtare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>91-100</td> <td>10 (dhjetë)</td> </tr> <tr> <td>81-90</td> <td>9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>71-80</td> <td>8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>61-70</td> <td>7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>51-60</td> <td>6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>0-50</td> <td>5 (pesë)</td> </tr> </tbody> </table>			Vlerësimi në %	Nota përfundimtare	91-100	10 (dhjetë)	81-90	9 (nëntë)	71-80	8 (tetë)	61-70	7 (shtatë)	51-60	6 (gjashtë)	0-50	5 (pesë)
Vlerësimi në %	Nota përfundimtare																
91-100	10 (dhjetë)																
81-90	9 (nëntë)																
71-80	8 (tetë)																
61-70	7 (shtatë)																
51-60	6 (gjashtë)																
0-50	5 (pesë)																

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Paul Craig, Grainne De Burca, The Evolution of te European Union Laë Oxford University Press, third edition 2021;</i></li> <li>• <i>Christian Dadomo and Noëlle Quéniwet, EUROPEAN UNION LAË, Third Edition, British Library Cataloguing in Publication Data, 2020;</i></li> <li>• <i>Hajredin Kuci, E Drejta Evropiane ne Kosove, Grup Autoresh, Hyrje ne sistemin ligjor te Kosoves, botues ADK, 2019. Prishtine fq. 71-102</i></li> <li>• Hajredin Kuci, Legal characteristics of EU-Kosova relations</li> <li>• Hajredin Kuci, International Legal cooperation of Kosova with other states and organizations,</li> <li>• <i>Iyola Solanke, EU Laë, LONGMAN LAË SERIES, Library of Congress Cataloging-in-Publication Data, First Edition 2015 John Fairhurst, “Law of the European Union” - Birmingham City University, 2010, seventh edition</i></li> <li>• <i>Margot Horspool &amp; Matthew Humphreys, “European Union Law” Oxford University Press, 2008.</i></li> <li>• <i>Ralf H. Folsom, ”Principles of European Union Law”, second Edition, Thomson Reuters , USA 2009.</i></li> <li>• <i>Christopher Hill and Michael Smith, “International Relations and the European Union”, Oxford University Prees 2005</i></li> <li>• <i>Paul De Grauwe, “ Economics of Monetary Union” Eighth Edition, Oxford University Press 2009</i></li> <li>• <i>Different web pages : European Commission, Ministry of Integration – Kosovo, and other web pages related to issues included in syllabus.</i></li> <li>• <i>Ian Bache and Matthew Flinders eds. 2004. Multi-Level Governance. Oxford: Oxford University Press.</i></li> <li>• <i>Liesbet Hooghe and Gary Marks. 2001. Multilevel Governance and European Integration. Rowman and Littlefield.</i></li> <li>• <i>Gary Marks and Marco Steenbergen, eds.</i></li> </ul>

	<p>2004. <i>Political Conflict and European Integration</i>. Cambridge: CUP.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• John McCormick. 2004. <i>The European Union: Politics and Policies</i>. Westview Press.</li> <li>• Brent F. Nelsen and Alexander C-G. Stubb eds. 2003. <i>The European Union: Readings on the Theory and Practice of European Integration</i>. Lynne Rienner Publishers.</li> <li>• John Peterson and Michael Shackleton eds. 2004. <i>The Institutions of the European Union</i>. Oxford: Oxford University Press.</li> <li>• Stephan Keukeleire and Jennifer MacNaughtan, "The Foreign Policy of the European Union" 2008.</li> <li>• Caner Onkol, "The eastern Enlargement of the European Union" Lambert Academic Publishers 2009.</li> <li>• Martin Neil Baily &amp; Jacob FunkKirkegaard- Institute for international Economics, "Transforming the European Economy" Washington DC 2004.</li> <li>• Jan Klabbers, "Conflict Treaty and the European Union", Cambridge 2009.</li> </ul>
<p><b>Literatura shtesë:</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ueb-faqja e UE-së: <a href="http://europa.eu/index_en.htm">http://europa.eu/index_en.htm</a></li> <li>• Gjykata Evropiane e Drejtësisë (ECJ): <a href="http://curia.europa.eu/">http://curia.europa.eu/</a></li> <li>• EURLEX për legjislacionin e KE-së: <a href="http://europa.eu/documents/eur-lex/index_en.htm">http://europa.eu/documents/eur-lex/index_en.htm</a></li> <li>• Traktatet e UE-së: <a href="http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/index.htm">http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/index.htm</a></li> <li>• Materiale tjera që u sillen studentëve në ligjërata dhe raste nga praktika</li> </ul>
<p><b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b></p>	
<p><b>Pjesa/Java</b></p>	<p><b>Ligjërata që do të zhvillohet</b></p>
<p><b>Pjesa I-rë</b></p> <p>Java e parë: Java e dytë:</p>	<p><b>Tema:</b></p> <p><b><u>Historiku</u></b></p> <p>Vështrim historik mbi Unionin Evropian dhe mbi integrimin</p>

	<p><i>Evropian</i></p> <p><i>A konsiderohet Unioni Evropian më shumë si Organizatë Ndërkombëtare apo si Shtet?</i></p> <p><i>E Drejta e Unionit Evropian-Nga Traktati i Parisit deri te Traktati i Lisbonës</i></p> <p><b><i>Kuptimi dhe përmbajtja e të Drejtës së UE-së</i></b></p> <p><i>E Drejta e Unionit Evropian-Kuptimi</i></p> <p><i>Burimet e të Drejtës së UE-së, hierarkia, procedura e nxjerrjes dhe efekti juridik i tyre</i></p> <p><i>E Drejta e UE-së, E Drejta e Brendshme (vendeve anëtare) dhe e Drejta Ndërkombëtare-Raporti hierarkik</i></p>
<p><b>Pjesa II-të</b></p> <p>Java e tretë: Java e katërt: Java e pestë:</p>	<p><b><i>Tema:</i></b></p> <p><b><i>Institucionet</i></b></p> <p><i>Institucionet Kryesore të Unionit Evropian-Roli dhe funksionet e tyre</i></p> <p><i>Institucionet më të rëndësishme politike të Unionit Evropian</i></p> <p><i>Institucionet ndërqeveritare dhe supranacionale të Unionit Evropian</i></p> <p><b><i>Funksionimi i Unionit Evropian</i></b></p> <p><i>Procesi i Vendimmarrjen në kuadër të Unionit Evropian</i></p> <p><i>Roli dhe funksioni i institucioneve të UE-së në procesin e vendimmarrjes</i></p> <p><i>Roli i institucioneve nacionale në procesin e vendimmarrjes në kuadër të UE-së me fokus parlamenteve nacionale;</i></p> <p><b><i>Prezantimi i Eseve të studentëve nga pjesa paraprake e ligjëratave</i></b></p>
<p><b>Pjesa III-tw</b></p> <p>Java e gjashtë: Java e shtatë:</p>	<p><b><i>Tema:</i></b></p>

<p><b>Java e tetë:</b></p>	<p><b>Zgjerimi i Unionit Evropian</b></p> <p><i>Momentet kyçe të zgjerimit të UE-së</i></p> <p><i>Prej kritereve ad hoc te kriteret formale për anëtarësim në Unionin Evropian</i></p> <p><b>Kriteret e Kopenhagës dhe Madridit</b></p> <p><i>Kriteret formale dhe joformale për anëtarësim në Unionin Evropian</i></p> <p><i>Procesi i Stabilizim Asocimit</i></p> <p><b>Republika e Kosovës në procesin e integritimit Evropian</b></p> <p><i>Kosova drejtë Unionit Evropian-Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim Asocimit (MPSA), Dialogu i Procesit të Stabilizim Asocimit (DPSA)</i></p> <p><i>Roli i institucioneve të Kosovës në procesin e integritimit evropian</i></p> <p><i>Pozita aktuale e Republikës së Kosovës në rrugën drejtë Unionit Evropian</i></p> <p><i>Marrëveshja e Stabilizim Asocimit-rol, rëndësia, efekti juridik benefitet dhe sfidat për Kosovën.</i></p> <p><b>Prezantimi i Eseve të studentëve nga pjesa paraprake e ligjëratave</b></p>
<p><b>Pjesa IV-t</b> <b>Java e nëntë:</b> <b>Java e dhjetë:</b></p>	<p><b>Tema:</b></p> <p><b>Tregu i Brendshëm i Unionit Evropian-Përpjekjet e Kosovës për tu bërë pjesë e tregut të brendshëm</b></p> <p><i>Çka është dhe si funksionon Tregu i Brendshëm i Unionit Evropian</i></p> <p><i>Katër liritë themelore të Tregut të Brendshëm-Vlerësimi i harmonizimit aktual të legjislacionit vendor lidhur me Tregun e Brendshëm</i></p> <p><b>Bazat e sistemit ekonomik dhe financiar në Unionin Evropian</b></p>



	<p><i>Unioni Ekonomik dhe Monetar</i></p> <p><i>Sistem Evropian i Bankave Qendrore-Banka Qendrore Evropiane</i></p> <p><i>Eurozona-Kuptimi, roli dhe funksionet e saj</i></p> <p><b><i>Prezantimi i Eseve të studentëve nga pjesa paraprake e ligjëratave</i></b></p>
<p><b>Pjesa V-të</b></p> <p>Java e njëmbëdhjetë: Java e dymbëdhjetë:</p>	<p><b><i>Tema:</i></b></p> <p><b><i>Marrëdhëniet ndërkombëtare të UE-së</i></b></p> <p><i>Roli i Përfaqësuesit të Lartë të UE-së për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë</i></p> <p><i>Misionet e Unionit Evropian-civile/ushtarake dhe misionet diplomatike</i></p> <p><i>Roli i Unionit Evropian në ruajtjen e paqes</i></p> <p><b><i>Prezantimi i Eseve të studentëve nga pjesa paraprake e ligjëratave</i></b></p>
<p><b>Pjesa e VI-të</b></p> <p>Java e trembëdhjetë: Java e katërbëdhjetë:</p>	<p><b><i>Tema:</i></b></p> <p><b><i>Politikat e Unionit Evropian</i></b></p> <p><i>Politikat e përbashkëta të Unionit Evropian</i></p> <p><i>Politikat në raport me vendet e treta</i></p> <p><i>Politika e fqinjësisë e UE-së- European Neighborhood Policy (ENP)</i></p> <p><b><i>Prezantimi i Eseve të studentëve nga pjesa paraprake</i></b></p>

Java e pesëmbëdhjetë:	<i>Mbrojtja publike e punimeve seminarike</i> <i>Provimi përfundimtar</i>
-----------------------	--

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p>Studentët duhet të jenë prezent, të paktën 80 përqind të fondit të ligjëratave dhe ushtrimeve.</p> <p>Studentët kërkohet të jenë pjesëmarrës aktivë në ligjërata dhe janë të obliguar të përgatisin esetë dhe seminarin e paraparë më këtë syllabus.</p> <p>Ligjëratat janë të obligueshme.</p>